



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4624 Prot

Lezhë, më 26 / 4 /2023

VENDIM

Nr. 22, Datë 25 . 04 .2023

“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUDHEN 01 – 31 MARS 2023 ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr.139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ , të nenit 21, të ligjit nr 57/2019 “Për asistencën në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, dt.04.09.2019 “Per përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM nr.565, dt. 09. 08.2006 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, VKM nr. 8, datë 14.01.2015 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për heqjen e fashës deri 300 KWH në muaj", nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

Miratimin e listës se familjeve për t’u trajtuar me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike për muajin **MARS 2023**.

- Tabelë përmbledhese sipas Njesive Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% per muajin **MARS 2023**.

Nr	Bashkia Lezhë/Njësiti	Nr. i familjeve	Masa e ndihmës 6%	Nr. i familjeve që përfitojnë kompensim	Masa e Kompensimit	Shkolla	Totali i Përfituar
1	LEZHË	23	95,293	5	6,440	1,800	103,533
2	SHENKOLL	27	121,549	13	16,744		138,293
3	KALLMET	2	9,086	2	2,576		11,662
4	ZEJMEN	8	33,262	6	7,728		40,990
5	BALLDREN	7	34,057	3	3,864	300	38,221
6	SHENGJIN	5	22,271	1	1,288		23,559
7	UNGREJ	6	20,039				20,039
8	DAJÇ	6	37,818				37,818
9	KOLSH	12	66,643	1	1,288		67,931
10	BLINISHT	2	11,066	1	1,288		12,354
	TOTAL	98	451,084	32	41,216	2,100	494,400

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 354/4 Prot.

Lezhë, më 27.04.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 22, datë 25.04.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2023"

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

